



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) duke vepruar në pajtim me nenin 7 të Ligjit 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 01/12 janar 2012), për herë të dytë shpallë:

NJOFTIM PUBLIK

PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

Njoftohen bartësit e së drejtës banesore (personat që posedojnë Vendimin mbi ndarjen e banesës dhe Kontratën për Shfrytëzimin e banesës) se me Ligjin 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike, për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar.

Bartësit e së drejtës banesore, të cilët të drejtën e banimit e kanë fituar nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim për blerjen e banesës Agjencisë Kosovare të Privatizimit në afat prej dy 2 (dy) vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-061, Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 01/12 janar 2012).

Kërkesat e kompletuara sipas Udhëzuesit për parashtrimin e kërkesës dorëzohen në Zyrën Qendrore të AKP-së në adresën: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Njësia për Regjistrimin e kërkesave, Rruga "Ilir Konushevci" 8, 10.000, Prishtinë, Kosovë. Kërkesa për blerjen e banesës (formulari) dhe UDHËZUESI për parashtrimin e kërkesës mund të merren në secilën Zyre Rajonale të AKP-së ose nga faqja elektronike: www.pak-ks.org (*Banesat*).

Komisioni për shitjen e banesave në kuadër të AKP-së, është në dispozicion të qytetarëve dhe mund të kontaktohet çdo ditë pune nga ora: 8:00 - 16:00, në numrin kontaktues: 038 500 400 lokali 2037.